

## KUJDESTARI

(Paragrafi 7 i Aktit për Shëndetin Mendor 1983)

1. Emri i pacientit	
2. Të dhënat e kujdestarit	
2.1 Emri	
2.2 Adresa	
2.3 Nr. i telefonit	
3. Autoriteti i juaj përgjegjës i shërbimeve sociale lokale	

### Ç'është kujdestaria?

Sipas paragrafit 7 të Aktit për Shëndetin Mendor 1983, personave që kanë çrregullime mendore ju caktohet një kujdestar për t'ju ndihmuar, nëse mjeku thotë se kjo është e nevojshme.

Kujdestari i juaj mund të jetë autoriteti i shërbimeve sociale lokale, ose një person i aprovuar nga autoriteti i shërbimeve sociale. Nëse kujdestari nuk është autoriteti i shërbimeve sociale, ata i quajmë "kujdestarë privat".

Kujdestari i juaj ka të drejtë ligjore t'ju thotë:

- ku duhet të jetoni
- të shkoni në takime për trajtim mjekësor, punë, shkollë ose trajnim në vende dhe orë të caktuara
- të lejoni mjekun ose një person të caktuar t'ju vizitoj.

## Pse kam nevojë për kujdestar?

Dy mjek mendojnë se ju keni nevojë për ndihmë për të jetuar në komunitet, sepse ju keni çrregullim mendor dhe ju keni nevojë për kujdestar për të mirën tuaj ose për t'i mbrojtur njerëzit e tjerë.

## Sa mund të zgjasë kjo?

Kujdestaria zgjatë deri në gjashtë muaj herën e parë.

Kujdestaria e juaj mund të përtërihet edhe për gjashtë muaj të tjerë, dhe përsëri nga një here në vit, nëse klinicisti i juaj përgjegjës ose mjeku i juaj i nominuar mendon se kjo është e nevojshme. Ata do të bisedojnë me ju lidhur me këtë sa më afër datës.

Klinicisti i juaj përgjegjës, ose një person tjetër, janë të caktuar nga autoriteti i shërbimeve sociale lokale për të vërtetuar nëse ju akoma keni nevojë për kujdestar. Nëse keni kujdestar privat, kjo do të bëhet përmes mjekut të quajtur "mjeku i nominuar".

## A mund të apeloj?

Nëse nuk doni të keni një kujdestar, ju duhet të bisedoni me kujdestarin tuaj, punonjësin tuaj social, klinicistin përgjegjës ose mjekun e nominuar.

Ju poashtu mund t'i shkruani autoritetit të shërbimeve sociale për të kërkuar përfundimin e kujdestarisë. Një person nga shërbimet sociale do të bisedoj me ju para marrjes së vendimit nëse keni nevojë për një kujdestar ose jo.

Më i afërmi i familjes tuaj mund të përfundoj kujdestarinë duke i shkruajtur autoritetit të shërbimeve sociale. Kjo fletëpalosje shpjegon më poshtë se kush është më i afërmi i familjes tuaj.

Poashtu ju mund të kërkonte nga Tribunali t'ju njoftoj se ju nuk keni më nevojë për kujdestar.

## Ç'është Tribunali dhe çfarë ndodhë?

Tribunali është një kuadro e pavarur i cili mund të vendos nëse ju akoma keni nevojë për kujdestar. Ky kuadër do të mbajë një mbledhje me ju dhe me stafin që ju njeh juve. Kjo mbledhje quhet "seancë". Nëse dëshironi, ju mund të kërkonte një person që të vjen në seancë për t'ju ndihmuar. Para seancës, anëtarët e Tribunalit do të lexojnë raportin lidhur me ju dhe kujdestarinë tuaj. Njëri nga anëtarët e Tribunalit do të vijë për të biseduar me ju.

## Kur mund të aplikoj tek Tribunali?

Ju mund të aplikoni tek Tribunal një herë gjatë gjashtë muajve të parë të kujdestarisë suaj. Pastaj ju mund të aplikoni edhe një herë gjatë gjashtë muajve të tjerë, dhe pastaj një herë në vit nëse jeni akoma nën kujdestari.

Nëse dëshironi të aplikoni tek Tribunali, ju mund t'i shkruani në adresën:

The Tribunals Service(Shërbimit i Tribunalit)  
PO BOX 8793  
5th Floor  
Leicester  
LE1 8BN

Tel. 0845 2232022

Ju mund të kërkonte nga avokati t'i shkruaj Tribunalit për ju dhe t'ju ndihmoj në seancë. Autoriteti i shërbimeve sociale dhe shoqata e drejtësisë kanë një listë të avokatëve të specializuar për këtë çështje. Ju nuk duhet të paguani avokatin për këtë ndihmë. Ky shërbim është falas në bazë të skemës për Ndihmë Ligjore.

## Njoftimi i anëtarit më të afërm familjar

Një kopje e kësaj fletëpalosje do ti jepet një personi të cilin Akti i Shëndetit Mendor e konsideron si më të afërmin e familjes tuaj.

Është një listë e njerëzve në Aktin e Shëndetit Mendor që konsiderohen si anëtar të familjes suaj. Zakonisht, personi që është në krye të listës është anëtari më i afërm familjar. Autoriteti i shërbimeve sociale mund t'ju jep një fletëpalosje e cila e shpjegon këtë dhe se çfarë të drejtash ka anëtari i juaj më i afërm familjar në lidhje me kujdesin dhe mjekimin.

Ne jemi njoftuar se në rastin tuaj, anëtari më i afërm familjar është:

Nëse ju nuk dëshironi që ky person të merrë një kopje të fletëpalosjes, ju lutem tregoni kujdestarit tuaj, punonjësit social ose personit që ju ka dhënë këtë fletëpalosje.

Nëse mendon se ky person nuk është i përshtatshëm të konsiderohet më i afërmi i familjes tuaj, ju mund të aplikoni tek Gjykata e Qarkut për të konsideruar një person tjetër si më të afërmin e familjes tuaj. Autoriteti i shërbimeve sociale mund t'ju jep një fletëpalosje e cila e shpjegon këtë.

## Kodi Praktik

Kodi Praktik është ai që jep këshilla lidhur me Aktin e Shëndetit Mendor njerëzve të përfshirë në kujdesin tuaj. Ata duhet të marrin parasysh se çfarë thot Kodi kur të marrin vendim lidhur me kujdesin tuaj. Nëse dëshironi , ju mund të kërkonti të shihni një kopje të Kodit.

### **Ndihmë dhe informacion të mëtejshëm**

Nëse ka diçka që nuk kuptoni lidhur me kujdesin dhe mjekimin, një anëtar i stafit do të përpiqet t'ju ndihmoj. Ju lutem kërkonti nga një anëtar t'ju shpjegoj nëse ka diçka në këtë fletëpalosje që nuk kuptoni, ose nëse keni ndonjë pyetje tjetër që nuk iu ka përgjegjur fletëpalosja.

Ju lutem kërkonti një kopje të kësaj fletëpalosje nëse i duhet edhe dikujt tjetër.